



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT**  
**NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE**

Në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, dispozitave të Rregullores Nr. 02/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L – 149, nenit 4 dhe 15 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit me datën 30.01.2018 shpall:

**KONKURS**  
**për plotësimin e vendit të punës**

<b>Pozita:</b>	Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun
<b>Referenca:</b>	ZLKP/ZKA/01-01/18
<b>Koeficienti:</b>	8 (tetë)
<b>Numri i pozitave:</b>	1 (një)
<b>Përgjegjësitë mbikëqyrëse:</b>	Jo
<b>I përgjigjet:</b>	Udhëheqësit të Njesisë për Komunikim me Publikun dhe Përkthime
<b>Vendi:</b>	Prishtinë

**Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:**

Hartimi, zhvillimi dhe zbatimi i strategjisë dhe planit të komunikimit për të informuar qytetarët, institucionet dhe komunitetin e biznesit për politikat, arritjet dhe aktivitetet e ZKA-së.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;
2. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin harton, zhvillon dhe zbaton planin e komunikimit për të informuar qytetarët dhe institucionet për politikat, arritjet dhe aktivitetet e ZKA-së dhe siguron redaktimin dhe përditësimin e tyre;
3. Harton dhe zhvillon politikat e fjalimeve dhe opinioneve për të gjitha temat e rëndësishme lidhur me aktivitet dhe shërbimet e e ZKA-së;
4. Përgatit kumtesa, informata, raporte dhe publikime tjera për publikun dhe pas miratimit të tyre nga mbikëqyrësi dhe menaxhmenti i ZKA-së dhe i shpërndan tek mediat e shkruara dhe elektronike dhe i vendos ne faqen e internetit të ZKA-së;
5. Përcjell takimet, seminarët, konferencat e ndryshme, që organizohen nga ZKA dhe njësitë organizative të saj dhe përgatit informatën për këto ngjarje;
6. Përgatit përgjigjet për kërkesat e pranuar nga mediat e shkruara dhe elektronike lidhur me aktivitetet dhe shërbimet e ZKA-së;

7. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin koordinon dhe përgatit konferenca për shtyp dhe takime tjera publike për menaxhmentin e lartë të ZKA-së;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

**Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Diplomë fakulteti në fushën e gazetarisë, komunikimit masiv ose në ndonjë fushë të përafërt;
- 3 vite përvojë pune profesionale në fushën e gazetarisë apo komunikimit masiv;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

**Procedura e Konkurrimit:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse. Zyra Kombëtare e Auditimit mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, te të gjitha komuniteteve.

Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Zyrës Kombëtare të Auditimit: <http://www.zka-rks.org/>

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org), nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në Zyrën Kombëtare të Auditimit, në rrugën “Musine Kokalari” nr. 87, prej orës 08:00 – 16:00. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025 dhe 038/606-004, ext:1005.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në shtypin ditor me datën 30 janar 2018 dhe mbetet i hapur deri më datën 14 shkurt 2018.

**Shënim:**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit, nuk do të pranohen. Të gjitha kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Divizioni për Burime Njerëzore.